



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 24.22.1-2013-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË ZYRËS SE RREGULLATORIT**  
**PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013**

**Prishtinë, Maj 2014**

---

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Valbon Bytyqi i mbështetur nga, Shehrije Shala (Udhëheqëse Ekipi) dhe Veton Misiri.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia .....	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
3 Rekomandimet e vitit paraprak .....	9
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli .....	9
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	19
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	22

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare për vitin 2013 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Drejtorin e Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2013 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 05 dhjetor 2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse për pasqyrat vjetore financiare të theksuara në Memon e Planifikimit të Auditimit;
- Veprimet e ndërmarra ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

### Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

<p>Pasqyrat financiare <i>prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë</i> në të gjitha aspektet materiale <b>(ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar)</b>.</p>
-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

## **Konkluzioni i përgjithshëm**

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Menaxhmenti i Zyrës Rregullore për Ujësjellës dhe Kanalizim kishte dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar. Kontrollat efektive kanë siguruar që menaxhimi i buxhetit të behët në pajtueshmëri me parimet e mirëfillta të menaxhimit financiar. Kjo ka siguruar që buxheti të ekzekutohet në pajtueshmëri të plotë me planin e rrjedhjes së parasë. Derisa, të të hyrat kishin rritje në 45% në raport me vitin e kaluar.

Me tutje, prokurimi i cili vazhdimisht cilësohet si fushë me rrezik të lartë ishte zhvilluar në pajtueshmëri me kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik. Kontrollat efektive vërehen edhe të menaxhimi i të arkëtueshmeve dhe obligimeve.

Më gjithë progresin e arritur, ne vërejtëm disa fusha në të cilat nevojiten kontrollat shtesë. Kjo përfshinë kryesisht pikën e kontrollit në procesin e pagesave. Në disa raste certifikimi dhe pagesa janë bërë në mungesë të dokumenteve të mjaftueshme. Derisa, të pasuria ekzistojnë evidenca të mjaftueshme për saktësinë dhe prezantimin e tyre në pasqyrat vjetore financiare, mirëpo softueri E-pasuria ende nuk është vënë në funksion.

## **Rekomandimet tona kryesore janë si në vijim:**

Drejtori i Zyrës Rregullore për Ujë dhe Kanalizim duhet të siguroj se:

- Zyrtari i certifikimit të pagesave do të verifikoj të gjitha kushtet e kontratës, dhe vetëm pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore të certifikohen pagesat;
- Është rishikuar mundësia e ndarjes së detyrave dhe përgjegjësi në mes të menaxhimit të financave dhe menaxhimit të personelit, në mënyrë që të mos krijohet mundësi për konflikte të mundshme interesi; dhe
- Është shqyrtuar mundësia, që në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike të vejë në funksion softuerin E-pasuria, në të cilin duhet të regjistrohen të gjitha pasuritë nën vlerën 1,000€ dhe stoqet.

## **Përgjigja e Menaxhmentit - auditimi 2013**

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe janë zotuar se do të adresojnë rekomandimet tona.

# 1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (ZRRUK) të përgatisë pasqyrat vjetore financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) dhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2012 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

## 2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Konkluzioni i përgjithshëm

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshinë një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

ZRRUK, ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore. PVF-të kanë përmbushur të gjitha kërkesat e SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr. 03/2013. Ato ofronin informata të sakta dhe të plota në lidhje me ngjarjet dhe transaksionet e prezantuara.

### 2.1 Opinioni i Auditimit

#### Opinion i pamodifikuar<sup>1</sup>

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale **(ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar)**.

---

<sup>1</sup> Termi „opinion i pamodifikuar“ është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar“ i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (ISSAI 200). Për më shumë informacion referohu në shtojcën I.

---

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

### Përshkrimi

PVF-të duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF - Nr 03/2013 për pasqyrat financiare vjetore të organizatave buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 dhe ndryshim - plotësimet e tij; dhe
- Kërkesat e Rregullores 01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike dhe rregullores MF-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare të organizatave buxhetore.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto kërkesa. Çështjet e ngritura në memon tonë të auditimit, të datës 05 dhjetor 2013, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga Menaxhmenti.

## 2.3 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

### Përshkrimi

Përveç hartimit të PVF-ve, nga ZRRUK kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesa Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Raportet operative (të performancës);
- Draft plani i prokurimit me kohë;
- Raportet mbi obligimet e pa paguara të dorëzuara në MF;
- Plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetëvlerësimit.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto kërkesa.



## 3 Rekomandimet e vitit paraprak

### Konkluzioni i përgjithshëm

ZRRUK, ka treguar gatishmëri të plotë për të adresuar rekomandimin e dhënë në raportin e auditimit për vitin 2012, përkatësisht janë ndërmarrë shumë veprime për t'i adresuar shqetësimet e ngritura. Ne e inkurajojmë menaxhmentin që të merr masat dhe veprimet e duhura për t'i adresuar edhe rekomandimet e këtij viti.

### Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e ZRRUK-ut për vitin 2012 ka rezultuar vetëm me një rekomandim. ZRRUK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të adresohet rekomandimi i dhënë.

Në auditimin e PVF-ve për vitin 2013 ne vërejtëm se ZRRUK, kishte adresuar plotësisht këtë rekomandim. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se adresimit të tyre, shihni Shtojcën II.

### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

### 4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është e fokusuar në kuptimin dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti, për të siguruar menaxhim efektiv financiar dhe kontroll. Ne vlerësojmë nëse kontrollet janë dizajnuar mirë, janë implementuar sipas planit apo funksionojnë në mënyrë efektive. Për ta bërë këtë, nevojitet vlerësimi i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të paraqitura nga menaxhmenti. Ne konsiderojmë çështje të veçanta siç janë: aplikimi i vetë-vlerësimit të MFK-së dhe vlerësimi i rrezikut.

Menaxhmenti i ZRRUK-ut kishte dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar. Kontrollet efektive kanë siguruar që menaxhimi i buxhetit të behët në pajtueshmëri me parimet e mirëfillta të menaxhimit financiar. Kjo ka siguruar që buxheti të ekzekutohet në pajtueshmëri të plotë me planin e rrjedhjes se parasë. Derisa, të të hyrat kishin rritje në 45% në raport me vitin e kaluar.

Me tutje, prokurimi i cili vazhdimisht cilësohet si fushë me rrezik të lartë ishte zhvilluar në pajtueshmëri me kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik. Kontrollë efektive vërehen të mbledhja e të arkëtueshmeve dhe menaxhimi i obligimeve.

Më gjithë progresin e arritur, ne vërejtëm disa fusha në të cilat nevojiten kontrollë shtesë. Kjo përfshinë kryesisht pikën e kontrollit në procesin e pagesave. Në disa raste certifikimi dhe pagesa janë bërë në mungesë të dokumenteve të mjaftueshme. Gjithashtu, ndarja e detyrave nuk ishte në nivelin e duhur. Derisa, te pasuria ekzistojnë evidenca të mjaftueshme për saktësinë dhe prezantimin e tyre, mirëpo softueri E-pasuria ende nuk është vënë në funksion.

## 4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

### Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për ZRRUK, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e mbledhura. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>328,619</b>	<b>328,619</b>	<b>313,213</b>	<b>318,024</b>	<b>273,323</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	328,619	328,619	313,213	318,024	34,363
Të hyrat vetanake <sup>3</sup>					238,960

Nga tabela më lartë vërejmë se buxheti final nuk ka pësuar ndryshime nga ai fillestar.

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

<sup>3</sup> Një pjesë e faturave të planifikuara dhe të mbledhura për Buxhetin e Kosovës në vitin aktual që është përdorur nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>328,619</b>	<b>328,619</b>	<b>313,213</b>	<b>273,323</b>	<b>315,250</b>
Pagat dhe Mëditjet	164,450	164,450	163,818	156,494	153,381
Mallrat dhe Shërbimet	156,519	156,519	143,958	112,303	157,590
Shërbimet komunale	7,650	7,650	5,438	4,526	4,279

ZRRUK, gjatë vitit 2013 ka shpenzuar 313,213€ apo 95% të buxhetit final. Krahasuar me realizimin e buxhetit të vitit 2012 (prej 97%), tregon se niveli i shpenzimit është i ngjashëm ndërmjet viteve dhe është tregues për performancën e mirë buxhetore në vazhdimësi. Realizimi i mirë i buxhetit vërehet edhe sipas kategorive ekonomike.

**Tabela 3. Të hyrat e inkasuara për buxhetin e Kosovës - realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Pranimet	2012 Pranimet	2011 Pranimet
Të hyrat vetanake	330,544	330,544	326,586	225,309	238,960
<b>Totali</b>	<b>330,544</b>	<b>330,544</b>	<b>326,586</b>	<b>225,309</b>	<b>238,960</b>

Në raport me vitin 2012, të hyrat vetanake kanë shënuar rritje, për 101,277€ ose 45%. Kjo tregon se ZRRUK, kishte angazhime shtesë gjatë vitit 2013 për grumbullimin e të hyrave.

### Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

### Përshkrimi

Për vitin 2013 ZRRUK ka planifikuar të hyra në vlerë 330,545€, ndërsa janë realizuar 326,586€. Shprehur në përqindje ZRRUK ka inkasuar 99% të të hyrave të planifikuara.

Burimet e të hyrave janë si në vijim:

- Të hyrat nga taksa e licencimit të operatorëve që merren me ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit; dhe
- Të hyrat nga gjobat.

Në fazën e auditimit të ndërmjetëm ne kemi vërejtur se të hyrat nga gjobat janë regjistruar në kodin e të hyrave nga licencat. Lidhur me këtë ne këshilluam menaxhmentin që të gjitha të hyrat të regjistrohen sipas kodeve adekuate dhe të prezantohen drejtë në PVF.

Menaxhmenti e ka adresuar në tërësi këshillën e dhënë. Të hyrat ishin prezantuar në PVF sipas kodeve adekuate

### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 4.4 Shpenzimet

### 4.4.1 Prokurimi

#### Përshkrimi

ZRRUK, gjatë vitit 2013 kishte nënshkruar 24 kontrata përmes procedurave të prokurimit. Për të testuar pajtueshmërinë e tyre me kornizën ligjore të prokurimit publik, ne kemi marrë si mostër 14 lëndë. Gjithashtu, ne kemi testuar 26 pagesa në vlerë 32,017€ të blerjeve, të cilat kanë kaluar përmes procedurave të prokurimit.

Ne kemi rishikuar procesin e blerjeve përmes prokurimit për të vlerësuar nëse ZRRUK ka zbatuar procedurat dhe i është përmbajtur dispozitave të ligjit të prokurimit publik. Ekzaminimet tona audituese kanë përfshirë tërë procesin e prokurimit, duke filluar nga inicimi i aktiviteteve të prokurimit e deri në menaxhimin dhe realizimin e kontratave.

Bazuar në këtë vjëmë në përfundim se prokurimi si proces ishte zhvilluar në pajtueshmëri me kërkesat ligjore të prokurimit. Megjithëse, në dy (2) raste kemi vërejtur parregullsi gjatë procesimit të pagesave. Rastet e tilla i kemi prezantuar në vijim:

---

### **Çështja 1 - Ekzekutimi i pagesave të cilat nuk ishin në përputhje me kontratën - Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Gjatë realizimit të kontratës “Shërbimet e ngjyrosjes, hekurosjes dhe rregullimit të gërvishtës së veturave të ZRRUK” në vlerë për 1,990€, pagesa nuk është procesuar në përputhje me kontratën.

Sipas kontratës, te neni 2.2 dhe 2.3, pagesa nga ana e Autoritetit kontraktues (AK) do të bëhet duke u bazuar në ofertën e dhënë në specifikacionin teknik, dhe pasi që Autoriteti Kontraktues pranon një fletëdërgesë nga Operatori Ekonomik (OE) lidhur me furnizimin e kryer.

AK ka proceduar pagesën në mungesë të dëshmive të përcaktuara me kontratë, përkatësisht në mungesë të një raporti të pranimit me detaje të shërbimit të përfunduar, përfshirë çdo pjesë të riparuar në sasi dhe vlerë.

**E gjetura** Sipas kontratës “Shërbimet - Teknikat e prezantimit” në vlerë për 1,980€, OE është dashur të dorëzojë një fletëdërgesë, e cila dëshmon se trajnimi është përfunduar, pastaj bazuar në këtë ekzekutohet pagesa.

Pagesa ishte ekzekutuar në mungesë të dëshmive se është mbajtur trajnimi. Kësaj lëndë i mungonin informatat si: analizat e nevojave paraprake për trajnim të stafit, miratimi i menaxhmentit për pjesëmarrje të stafit në trajnime, fletëdërgesa, si dhe ndonjë sqarim shtesë apo listë që tregon pjesëmarrësit në trajnim.

Të gjeturat e lartpërmendura janë identifikuar në fazën e ndërmjetme të auditimit. Pas dorëzimit të memos së auditimit në dhjetor të vitit 2013, menaxhmenti kishte marrë masa dhe i kishte kompletuar me dëshmitë e nevojshme.

**Rreziku** Ekzekutimi i pagesave, duke anashkaluar kërkesat e përcaktuara me kontratë, përkatësisht në mungesë të dëshmive se janë ofruar shërbimet e kontraktuara, krijon mundësinë që të paguhen fatura akoma pa u pranuar mallrat ose shërbimet.

**Rekomandimi 1** Drejtori i ZRRUK-ut duhet të siguroj se Zyrtari i certifikimit të pagesave do të verifikoj të gjitha kushtet e kontratës, dhe vetëm pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore të certifikohen pagesat.

---

## 4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

### Përshkrim

Në kategorinë e shpenzimeve tjera për të cilat nuk nevojitet të zhvillohen procedura të prokurimit, ne kemi testuar disa pagesa për mallra dhe shërbime përfshirë: shpenzimet komunale, shpenzimet e qirasë, shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e përfaqësimit.

Në këtë fushë nuk kemi identifikuar ndonjë çështje për të raportuar.

### Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

### Përshkrimi

Buxheti për paga dhe mëditje për vitin 2013 ishte 164,450€. Nga këto janë shpenzuar 163,818€, përkatësisht afro 100% të buxhetit. Numri i pozitave të aprovuara për vitin 2013 është 19, ndërsa numri aktual i punëtorëve në fund të vitit sipas listës se pagave ishte 18.

Për të mbuluar auditimin në këtë kategori të shpenzimeve ne testuam 11 mostra. Testimet kanë përfshirë rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin, pagesat për secilin muaj, pajtueshmërinë e pagesave të pagave në raport me kontratat e punës, përfshirë edhe bazën e koeficienteve, vlerësimin vjetor të performancës, dhe mirëmbajtjen e dosjeve të personelit.

Gjatë vitit 2013, ZRRUK, nuk kishte ndryshime në listat e të punësuarve, me përjashtim të një rasti në të cilin një i punësuar e kishte ndërprerë marrëdhënien e punës.

Bazuar në këtë, konstatojmë se ZRRUK kishte menaxhuar pagat në pajtueshmëri të plotë me Legjislacionin, më përjashtim të një rasti lidhur me ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi.

## Çështja 2 - Ndarje jo e duhur e detyrave dhe përgjegjësi - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Ndarja e detyrave dhe përgjegjësi nuk është në nivelin e duhur. Kryesuesi i Administratës dhe Financave kryen edhe detyrat e Menaxhimit të Personelit.
- Rreziku** Caktimi i disa detyrave një personi të vetëm, reflekton mungesën e kontroleve dhe dobëson aspektin e llogaridhënies.
- Rekomandimi 2** Drejtori i ZRRUK-ut duhet të rishikoj mundësinë e ndarjes së detyrave dhe përgjegjësi në mes të menaxhimit të financave dhe menaxhimit të personelit, në mënyrë që të mos krijohet mundësi për konflikte të mundshme interesi.

## 4.5 Pasuritë dhe detyrimet

### 4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

#### Përshkrimi

Zyrtari i pasurisë ka mbajtur dy regjistra për evidentimin e pasurisë: regjistrin kontabël në të cilin janë të prezantuar pasuritë mbi 1,000€ dhe regjistrin e përgjithshëm të pasurisë në të cilin janë prezantuar të gjitha pasuritë përfshirë edhe ato me vlerë nën 1,000€. Në fund të vitit gjithashtu kanë bërë edhe inventarizimin e pasurisë.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit, mënyra e mbajtjes së evidencës dhe menaxhimi i pasurive në ZRRUK është konform kërkesave ligjore. Bazuar në këtë vjëmë në ZRRUK, kishte kontrole të mira në menaxhimin e pasurive.

Megjithatë, ne identifikua se ZRRUK, nuk kishte në funksion softuerin e E-pasuria për regjistrimin e pasurisë nën 1,000€, si dhe në një rast identifikua se pasuria është evidentuar më vonë.

### Çështja 3 - Vonesa në regjistrimin e pasurisë -Prioritet i mesëm

- E gjetura** ZRRUK, nuk kishte bërë azhurnimin e vazhdueshëm të regjistrimit të pasurisë. Blerja e fotokopjes në vlerë prej 2,580€, nuk ishte regjistruar në SIMFK në momentin e blerjes. Blerja është bërë në muajin shkurt të vitit 2013, ndërsa është regjistruar në muajin tetor 2013, me tetë (8) muaj vonesa. Megjithatë kjo blerje ishte shpalosur si pasuri në PVF.
- Rreziku** Vonesat në regjistrimin e pasurive në regjistrin kontabël ndikon në nënvlerësimin e pasurisë se prezantuar.
- Rekomandimi 3** Drejtori i ZRRUK-ut në koordinim me zyrtarët përgjegjës të ZRRUK-ut, duhet të siguroj azhurnimin e vazhdueshëm të regjistrimit kontabël të pasurisë, si dhe prezantimit të plotë të tyre në raportet financiare.

### Çështja 4 - Mos funksionalizimi i sistemit E-pasuria

- E gjetura** ZRRUK ka mbajtur regjistrin e përgjithshëm të pasurisë në të cilin janë të prezantuara të gjitha pasuritë mbi dhe nën vlerën 1,000€. Gjithashtu ka mbajtur regjistrin kontabël SIMFK në të cilin janë të regjistruara të gjitha pasuritë më vlerë mbi 1,000€.
- Mirëpo, edhe përpos kësaj rregulloja MF 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, e cila ka hyrë në fuqi në muajin dhjetor 2013, te neni 6.3, i obligon të gjitha organizatat buxhetore që pasuritë kapitale duhet të regjistrohen në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen te "E-pasuria". Mirëpo, deri në muajin mars të vitit 2014, (fazën përfundimtare të ekzekutimit të terrenit) ky softuer ende nuk është vënë në funksion të institucionit.
- Rreziku** Mos përdorimi i Softuerit E- Pasuria mund të shkaktoj që në të ardhmen ZRRUK mos të arrij të dorëzoj raporte të plota dhe të sakta sipas formateve standarde të kërkuara.
- Rekomandimi 4** Drejtori i ZRRUK-ut duhet të shqyrtoj mundësinë, që në bashkëpunim me Ministrinë së Administratës Publike të vejë në funksion softuerin E-pasuria, në të cilin duhet të regjistrohen stoqet dhe të gjitha pasuritë nën 1,000€.



## 4.5.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

### Përshkrim

Vlera e përgjithshme e llogarive të arkëtueshme të prezantuara në PVF ishte 17,176€.

ZRRUK, gjatë vitit 2013 ka faturuar 338,586€ si taksa të licensimit për kompanitë që merren me ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit. Prej tyre ka inkasuar 326,586€ ose afër 97% të faturave të lëshuara.

Ndërsa sa i përket inkasimit të obligimeve të mbetura nga vitet paraprake të cilat rrjedhin kryesisht nga Kompanitë të cilat merren më grumbullimin e mbeturinave, ZRRUK ka filluar ri programimin e borxheve. Me një operator vetëm e kanë ri programuar borxhin pas vendimit të Gjykatës, ndërsa për obligimet tjera janë duke vazhduar procedurat gjyqësore.

### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 4.5.3 Trajtimi i borxheve

### Përshkrimi

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2013 ishte 647€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2014. Të gjitha obligimet e mbetura ndërlidhen me faturat për shërbime komunale të pranuar pas datës 20 dhjetor 2013.

Nga kjo, vijmë në përfundim se ZRRUK ka kontrolle të mira në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve. Ajo ka dorëzuar raporte të rregullta mujore në pajtim më kërkesat e Rregullës financiare nr. 02/2013/MF për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore.

Përpos kësaj, kontrollet e mira ekzistonin edhe në ekzekutimin e pagesave. Të gjitha faturat e pranuar ishin procesuar me kohë për pagesë

### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë

## 4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

### **Përshkrimi**

Në bazë të kërkesave të parapara me U.A. nr.23/2009 për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), ZRRUK nuk i plotëson kushtet për themelimin e kësaj njësie.

Megjithatë ZRRUK, ka treguar përkushtim për vlerësimin e funksionimit aktual të kontrolleve. Përmes NJAB në kuadër të Ministrisë së Financave, kanë realizuar një auditim të brendshëm me objektivë “Rishikimi i Funksionimit të ZRRUK”-ut. për periudhën janar - qershor 2013.

NjAB në kuadër të MF-së kishte dhënë pesë (5) rekomandime të cilat kryesisht kanë të bëjnë me performancën e Institucionit. ZRRUK ka filluar të adresojë rekomandimet e dhëna.

### **Rekomandimet**

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori

---

duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

<b>Komponenti i Auditimit</b>	<b>Rekomandimet e dhëna</b>	<b>Rekomandimet plotësisht të adresuara</b>	<b>Rekomandimet pjesërisht të adresuara</b>	<b>Rekomandimet e pa adresuara</b>
4.3. Kërkesat e raportimit	Planifikimi i prokurimit të përfshijë vetëm ato blerje për të cilat duhet zhvillohen procedurat e prokurimit në përputhje me Ligjin e Prokurimit.	Po		